REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 741/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.741/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Goran Milenkovic - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi – Referues, Z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Olti Trasing" - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i shkollës në Nerodime", me nr. të prokurimit: 656-20-3581-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Ferizaj, më datë 30.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Olti Trasing" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: : "Ndërtimi i shkollës në Nerodime", me nr. të prokurimit: 656-20-3581-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në Nerodime", me nr. të prokurimit: 656-20-3581-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Ferizaj dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Olti Trasing" - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "Olti Trasing" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 01.10.2020 me nr.741/20, kundër njoftimit për anulim të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i shkollës në Nerodime", me nr. të prokurimit: 656-20-3581-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Komuna Ferizaj, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 62 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 40, 41 dhe 44 i RrUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 08.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

OE ankues pretendon se AK ka bërë shkeljen e LPP-së duke mos respektuar nenin 62 të LPP-së (Përfundimi i Procedurave të Prokurimit), nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për procedurën e vlerësimit, pra AK nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të eliminimit, por vetëm ka ngarkuar vendimin e AK-së për anulim të procedurës.

AK nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së – Barazia në trajtim/jo-diskriminim, por ka vepruar njëanshëm duke e anuluar procedurën pa i trajtuar ofertat sipas nenit 59 të LPP-së.

AK po ashtu ka bërë shkeljen e nenit 108/A – Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve, sepse nuk i ka trajtuar/shqyrtuar kërkesat për rishqyrtim sipas pretendimeve ankimore, por AK e ka anuluar procedurën, pra AK e ka shkelur paragrafin 2 t nenit 108/A që thotë (citim):

Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon Autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

Pra, AK duhet te shqyrtoj çdo kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues si arsye të anulimit të procedurës ka sqaruar se:

Kërkesë nga DA për anulimin e aktivitetit të prokurimit për arsye të mospërputhjes së projektit me paramasën në nivele që nuk mund të anashkalohen.

AK është dashur të analizoj dhe të vendosë para hapjes çdo ndryshim apo mospërputhje të projektit me "Njoftim për korrigjim të procedurës", e jo të bëj hapjen pa e harmonizuar projektin. Pra, anulimi i procedurës është dashur të bëhet para datës së hapjes sipas nenit 62 të LPP-së. Paragrafi 2.2 i nenit 62 të LPP-së thotë (citim):

"para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe

që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve". Pra, eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me shkeljet e lartshënuara, pretendimi i OE ankues është i bazuar pasi që nuk janë respektuar dispozitat e LPP-së. Pra, AK në fazën e rivlerësimit të respektoj kriteret e FDT-së dhe NJPK-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK t'i respektoj kriteret e përcaktuara nga AK si në FDT dhe NJK, sipas nenit 59 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë 20.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.
Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Olti Trasing" – Prishtinë, se AK ka bërë shkeljen e LPP-së duke mos respektuar nenin 62 të LPP-së (Përfundimi i Procedurave të Prokurimit), nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për procedurën e vlerësimit, pra AK nuk ka dhënë ndonjë arsyetim të eliminimit, por vetëm ka ngarkuar vendimin e AK-së për anulim të procedurës. Më tej, OE ankues pretendon se AK nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së – Barazia në trajtim/jo-diskriminim, por ka vepruar njëanshëm duke e anuluar procedurën pa i trajtuar ofertat sipas nenit 59 të LPP-së.
Paneli Shqyrtues sqaron se autoritet kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së duke mos i ka trajtuar/shqyrtuar kërkesat për rishqyrtim sipas pretendimeve ankimore por ka anuluar procedurën, ku në paragrafin 2 të nenit 108/A thuhet:

> Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon Autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

Pra, në bazë të dispozitë së lartcekur, AK duhet te shqyrtoj çdo kërkesë për rishqyrtim sipas nenit 108/A të LPP-së. Lidhur me arsyen e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, AK ka sqaruar kërkesë nga DA për

anulimin e aktivitetit të prokurimit për arsye të mospërputhjes së projektit me paramasën në nivele që nuk mund të anashkalohen.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK është dashur të analizoj dhe të vendosë para hapjes për çdo ndryshim apo mospërputhje të projektit me "Njoftim për korrigjim të procedurës", e jo të bëjë hapjen pa e harmonizuar projektin. Pra, anulimi i procedurës është dashur të bëhet para datës së hapjes sipas nenit 62 të LPP-së. Paragrafi 2.2 i nenit 62 të LPP-së thotë:

> "para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve".

Pra, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se lidhur me shkeljet e lartshënuara, pretendimi i OE ankues është i bazuar pasi që nuk janë respektuar dispozitat e LPP-së. Pra, AK në fazën e rivlerësimit të respektoj kriteret e FDT-së dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me par. 2.2 të nenit 62 të LPP-së, duke e anuluar këtë aktivitet pas hapjes së tenderëve. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, njëherit duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna Ferizaj

1x1 OE "Olti Trasing"- Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.